

IT-04-84-R77.4
DL-1/882 Quater
20 August 2008

Përkthim
4/882 Quater
NC

**KOMBET E
BASHKUARA**



Tribunali Ndërkombëtar për Ndjekjen
Penale të Personave Përgjegjës për
Shkelje të Rënda të së Drejtës
Humanitare Ndërkombëtare të Kryera
në Territorin e ish-Jugosllavisë prej
Vitet 1991

Lënda Nr. IT-04-84-R77.4

Data: 15 gusht 2008

Originali: anglisht

NË DHOMËN GJYQËSORE I

Para: Gjykatësit Alphons Orië, Kryegjykatës
Gjykatëses Christine van den Wyngaert
Gjykatësit Bakone Justice Moloto

Sekretari: Z. Hans Holthuis

Urdhër i datës: 15 gusht 2008

PROKURORI

kundër

**ASTRIT HARAQISË
dhe
BAJRUSH MORINËS**

PUBLIK

**URDHËRESË PËR SHFUQIZIMIN E LIRIMIT TË PËRKOHSHËM ME KUSHT TË
ASTRIT HARAQISË DHE BAJRUSH MORINËS**

Zyrës së Prokurorit:

Z. Serge Brammertz
Z. Dan Saxon

**Misionit të Administratës së Përkohshme
të Kombeve të Bashkuara në Kosovë**

Avokatëve të të Akuzuarve:

Z. Karim A.A. Khan për Astrit Haraqinë
Z. Jens Dieckman për Bajrush Morinën

Qeverisë së Mbretërisë së Holandës

DHOMA GJYQËSORE I (“Dhoma Gjyqësore”) e Tribunalit Ndërkombëtar për Ndjekjen Penale të Personave Përgjegjës për Shkelje të Rënda të Së Drejtës Humanitare Ndërkombëtare të Kryera në Teritorin e ish-Jugosllavisë që prej vitit 1991 (“Tribunali”);

DUKE MARRË SHËNIM “Vendimin në lidhje me Kërkesën për Lirimin e Përkohshëm me Kusht të Astrit Haraqisë”, dorëzuar publikisht më 13 maj 2008, dhe “Vendimin në lidhje me Mocionin e Mbrojtjes për Lirimin e Përkohshëm me Kusht të të Akuzuarit Bajrush Morina, dorëzuar publikisht më 13 maj 2008, ku Dhoma Gjyqësore përcaktoi kushtet e lirit të përkohshëm të Astrit Haraqisë dhe Bajrush Morinës dhe urdhëroi Astrit Haraqinë dhe Bajrush Morinën, “t’i përmbahet rreptësisht çfarëdo Urdhërese tjetër të Dhomës Gjyqësore që mund të ndryshojë kushtet e lirit të tij të përkohshëm ose ta përfundojë atë” dhe “të kthehet në Njësinë e Paraburgimit të Kombeve të Bashkuara (“UNDU”) në Hagë në një kohë që do të përcaktohet prej Dhomës Gjyqësore”;¹

DUKE MARRË PARASYSH se procesi gjyqësor në këtë çështje është caktuar të zhvillohet për periudhën 8-12 shtator 2008;²

BAZUAR NË Nenin 29 të Statutit të Tribunalit dhe Rregullat 54 dhe 65 të Rregullores së Procedurës dhe Provave;

URDHËRON:

1. Astrit Haraqinë dhe Bajrush Morinën që të kthehen në UNDU në Hagë më 3 shtator 2008;
2. Misionin e Administratës së Përkohshme të Kombeve të Bashkuara në Kosovë (“UNMIK”) që të caktojë një zyrtar që do të shoqërojë Astrit Haraqinë dhe Bajrush Morinën prej vendbanimeve të tyre në Kosovë për në aeroportin e Prishtinës, më 3 shtator 2008;

¹ Decision on Application for Provisional Release of Astrit Haraqija, 13 May 2008, para 17 and Decision on Defence Motion for Provisional Release of the Accused Bajrush Morina, 13 May 2008, para 17./Vendim në lidhje me Kërkesën për Lirim të Përkohshëm të Astrit Haraqisë, 13 maj 2008, paragrafi 17 dhe Vendim në lidhje me Mocionin e Mbrojtjes për Lirimin e Përkohshëm të të Akuzuarit Bajrush Morina, 13 maj 2008, paragrafi 17.

² Decision on Haraqija and Morina Requests for Reconsideration of Scheduling Order and for Certification for Appeal, 29 May 2008/Vendim në lidhje me Kërkesat e Haraqisë dhe Morinës për Rishikimin e Urdhërimit të Aktit dhe të Lejvimit të Apelit, 29 maj 2008.

3. UNMIK-un që t'u bëjë të ditur Dhomës Gjyqësore dhe Sekretarit të Tribunalit sa më shpejt që të jetë e mundur emrin e zyrtarit të caktuar;
4. që në aeroportin e Prishtinës Astrit Haraqija dhe Bajrush Morina të dorëzohen përkohësisht në ruajtjen e oficerit të sigurimit caktuar prej Sekretarit të Tribunalit i cili do t'i shoqërojë Astrit Haraqinë dhe Bajrush Morinën për pjesën tjetër të udhëtimit për në aeroportin Schiphol;
5. që në aeroportin Schiphol Astrit Haraqija dhe Bajrush Morina të dorëzohen në mbikëqyrjen e autoriteteve holandeze dhe të transportohen për në UNDU, më 3 shtator 2008;
6. UNMIK-un që të garantojë sigurinë dhe mirëqenien personale të Astrit Haraqisë dhe Bajrush Morinës deri kur ata t'i dorëzohen oficerit të sigurimit caktuar prej Sekretarit të Tribunalit më 3 shtator 2008;
7. Sekretarin e Tribunalit që të garantojë sigurinë dhe mirëqenien personale të Astrit Haraqisë dhe Bajrush Morinës deri kur ata t'i dorëzohen autoriteteve holandeze në aeroportin Schiphol më 3 shtator 2008;
8. Qeverinë e Mbretërisë së Holandës që të mundësojë transportimin me roje të Astrit Haraqisë dhe Bajrush Morinës nga aeroporti Schiphol për në UNDU;

UDHËZON:

1. Sekretarin e Tribunalit që të konsultohet me Ministrinë e Drejtësisë së Holandës në lidhje me masat praktike të kthimit të Astrit Haraqisë dhe Bajrush Morinës në UNDU;
2. UNMIK-un, Qeverinë e Mbretërisë së Holandës dhe Sekretarin e Tribunalit që të komunikojnë me njëri-tjetrin për të mundësuar kthimin pa probleme në UNDU të Astrit Haraqisë dhe Bajrush Morinës;

U KËRKON autoriteteve të shteteve nëpërmjet territorit të të cilëve mund të kalojnë Astrit Haraqija dhe Bajrush Morina:

1. që të mbajnë në ruajtje Astrit Haraqinë dhe Bajrush Morinën gjatë kohës që ata do të jenë tranzit; dhe
2. që të arrestojnë dhe paraburgosin Astrit Haraqinë dhe Bajrush Morinën deri në kthimin e tyre në UNDU në Hagë, nëqoftëse orvaten të arratisen

Përpiluar në anglisht dhe frengjisht; teksti në anglisht ka përparësi.

/nënshkruar në origjinal/
Gjykatës Alphons Orié
Kryegjykatës

Sot, më datën 15 gusht 2008.
Në Hagë
Holandë

[Vula e Tribunalit]